



**UDHËZUES INFORMATIV PËR QASJEN NË PRONË  
DHE TË DREJTAT PRONËSORE  
TË GRAVE DHE TË BURRAVE NË KOSOVË**





# UDHËZUES INFORMATIV PËR QASJEN NË PRONË DHE TË DREJTAT PRONËSORE TË GRAVE DHE TË BURRAVE NË KOSOVË



## PËRMBAJTJA

HYRJE .....	4
ÇFARË ËSHTË GJINIA DHE BARAZIA GJINORE?.....	5
CILI ËSHTË QËLLIMI I LIGJIT PËR BARAZI GJINORE DHE PROGRAMIT TË KOSOVËS PËR BARAZI GJINORE? .....	6
ÇFARË MEKANIZMA EKZISTOJNË PËR PËRKRAHJEN E BARAZISË GJINORE NË KOSOVË? .....	6
ÇFARË ËSHTË PRONA DHE ÇFARË JANË TË DREJTAT PRONËSORE?.....	7
LLOJET E REGJISTRIMIT TË PRONËS – ÇKA ËSHTË PRONËSIA E VETME? .....	8
LLOJET E REGJISTRIMIT TË PRONËS – GJATË LIDHJES SË MARTESËS, GJATË MARTESËS DHE PAS MARTESËS? .....	9
ÇFARË ËSHTË E DREJTA E TRASHËGIMISË? .....	10
E DREJTA E BANIMIT – PËRFSHIRJA E GRAVE DHE BURRAVE NË PLANIFIKIM HAPËSINOR NË NIVEL TË KOMUNËS .....	11
PËRGJEGJËSITË E KOMUNAVE PËR SIGURIMIN E BANIMIT SOCIAL – PËRFSHIRJA E PERSPEKTIVËS SË BURRAVE DHE GRAVE.....	12
VENDBANIMET JOFORMALE DHE NDIKIMI I TYRE TE GRATË DHE BURRAT.....	14
CILËT JANË HISEDARËT NË KOMUNË? .....	15
LISTA E BURIMEVE .....	17

## HYRJE

Gëzimi i barabartë i të drejtave nga burrat dhe gratë mbetet sfidë në Kosovë dhe njëri prej treguesve që e reflekton këtë gjë është qasja në të drejtat pronësore dhe banesore. Ndonëse korniza ligjore në Kosovë siguron mundësi të barabarta për burrat dhe gratë në sërë çështjesh që lidhen me aspektin pronësor dhe banesor, në praktikë, sfidat për zbatimin e ligjeve bashkë me normat shoqërore me prirje për të favorizuar burrat, shkelin mbi mundësinë e grave për t'i gëzuar në mënyrë të barabartë të drejtat e tyre në këtë drejtim.

Për t'i tejkualuar disa prej këtyre sfidave, ky udhëzues synon të ofrojë informata të qarta dhe të kuptueshme për burimet në dispozicion për t'iu siguruar grave qasje të barabartë në të drejtat pronësore dhe banesore në Kosovë. Pas një hyrjeje të shkurtër informative rreth kornizës gjinore, si dhe asaj aktuale ligjore, të politikave dhe barazisë gjinore, udhëzuesi ofron përgjigje praktike për të drejtat pronësore dhe banesore që për cak kanë gratë dhe e sqaron ndikimin specifik të aspekteve të përzgjedhura pronësore dhe banesore tek gratë.

Ky udhëzues është i dizajnuar për gratë që janë të interesuara të mësojnë më shumë rreth të drejtave të tyre pronësore dhe banesore, si dhe për organizatat e shoqërisë civile dhe organet komunale si udhëzues i tyre për të ofruar dhe siguruar përkrahje dhe shërbime për gratë mbi të drejtat pronësore dhe banesore. Është vegël që shërben për t'i informuar si gratë ashtu edhe burrat për këto çështje dhe për ofrimin e një planifikimi gjithëpërfshirës dhe hollësitë për kontaktim të hisedarëve kryesorë në nivel komunal, ku ata mund t'i adresojnë pyetjet dhe shqetësimet e tyre.

Informacioni i ofruar kryesisht bazohet në kornizën ligjore dhe të politikave në Kosovë që rregullon barazinë gjinore, të drejtat pronësore dhe banesore, si dhe rezultatet e gjeneruara gjatë trajnimit të trajnuesve nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për të drejtat gjinore dhe pronësore në Kosovë, mbajtur më 2014-2015.

## ÇFARË ËSHTË GJINIA DHE BARAZIA GJINORE?

Për ta kuptuar se si gjinia mund të luaj rol në gëzimin e barabartë të të drejtave pronësore dhe banesore nga burrat dhe gratë, është e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm se çfarë është gjinia dhe barazia gjinore. Për OSBE-në, **barazia gjinore** përkufizohet si ushtrim i plotë dhe i barabartë i të drejtave themelore të njeriut nga burrat dhe gratë. Është mungesa e diskriminimit apo dallimi në bazë të të qenit grua apo burrë në mundësi të ofruara, ndarje të resurseve, qasje në shërbime, si dhe në gëzim të të drejtave. Qëllimi nuk është që gratë dhe burrat të bëhen identik, por që mundësitë dhe përfitimet e tyre të bëhen dhe të mbesin të njëjta. Për ta kuptuar barazinë gjinore, është e rëndësishme të kuptohet dallimi në mes **seksit** dhe **gjinisë**. Derisa **seksi** i referohet apo nënkupton karakteristikat biologjike të burrave dhe grave, **gjinia** i referohet përkufizimeve të krijuara shoqërore të roleve për gratë dhe burrat. Gjinia është identitet i fituar që është qendror për të dy sekset, mësohet, ndryshon me kohë, dhe dallon gjerësisht brenda kulturave të ndryshme. Ka gjithashtu standarde dhe konventa ndërkombëtare të krijuara për të promovuar barazinë gjinore, duke përfshirë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas dhe këto standarde përcaktojnë përkufizime të ngjashme të koncepteve që lidhen me gjininë.

**Stereotipat gjinorë** janë të pranishëm në të gjitha shoqëritë. Stereotipat gjinore janë opinione ose role të përgjithshme të vlefshme për burrat dhe gratë bazuar në supozime të fiksuara padrejtësisht. Këto stereotipa i reflektojnë normat e zakonshme shoqërore se si do të duhej të sillen një grua, burrë, vajzë apo djalë. Stereotipat gjithashtu luajnë një rol të madh në ruajtjen e pabarazisë gjinore në shoqëri dhe mund të çojnë në **diskriminim gjinor**. **Diskriminimi i bazuar në gjini** i referohet çfarëdo dallimi, përjashtimi ose kufizimi të bërë në bazë të roleve gjinore të krijuara nga shoqëria që ia parandalon personit gëzimin e të drejtave të njeriut dhe mundësive, si dhe të drejtën për të kontribuar dhe ndikuar.

Prandaj, ndonëse sipas ligjit burrat dhe gratë në Kosovë janë të barabartë në gëzimin e të drejtave të tyre pronësore-banesore, praktikat shoqërore dhe zakonore mund ta pengojnë barazinë.

## CILI ËSHTË QËLLIMI I LIGJIT PËR BARAZI GJINORE<sup>ii</sup> DHE PROGRAMIT TË KOSOVËS PËR BARAZI GJINORE?

**Ligji për barazi gjinore** e siguron kornizën ligjore për të ofruar mundësi të barabarta të pjesëmarrjes për burrat dhe gratë në fushën politike, ekonomike, sociale dhe të tjera fusha të jetës shoqërore në Kosovë. Ligji gjithashtu synon të krijojë kushte dhe mundësi për barazi gjinore përmes politikave që e mbështesin zhvillimin e përgjithshëm, *veçanërisht për përmirësimin e statusit të gruas*, ashtu që të kenë qasje të barabartë në mundësi.

*Programi i Kosovës për Barazi Gjinore* siguron kornizën e politikave për ta institucionalizuar qasjen dhe pjesëmarrjen si të burrave ashtu edhe të grave në të gjitha aspektet e jetës. Megjithatë, Programi gjithashtu njihet që gratë nuk i gëzojnë aktualisht të drejtat e tyre si burrat dhe se duhet të adresohen fusha specifike në mënyrë që të punohet në drejtim të barazisë gjinore në Kosovë. Programi i ka identifikuar gjashtë fusha vijuese ku kërkohet fokus:

- Integrimi i gruas në ekonomi
- Integrimi i gruas në tregun e punës dhe kujdes social për kategoritë e prekura nga problemet sociale
- Gruaja në proceset vendimmarrëse
- Kujdesi shëndetësor dhe qasja e grave dhe burrave në shërbime shëndetësore
- Arsimi
- Përfaqësimi dhe kontributi në kulturë dhe media.

## ÇFARË MEKANIZMA EKZISTOJNË PËR PËRKRAHJEN E BARAZISË GJINORE NË KOSOVË?

**Në nivel qendror, janë:**

Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit: përgjegjëse për promovimin, përkrahjen, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e Ligjit për barazi gjinore dhe legjislacione të tjera të ndërlidhura.

Njësia për barazi gjinore, trafikim me qenie njerëzore dhe dhunë e Departamentit kundër Diskriminimit të Institucionit të



Ombudspersonit: përgjegjëse për hetimin e ankesave që lidhen me përputhshmërinë e veprimeve të institucioneve me kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që lidhet me barazinë gjinore.

Zyrtarë për barazi gjinore në nivel të ministrive – përgjegjës për promovimin e barazisë gjinore brenda ministrive të tyre përkatëse.

Këshilli ndërministror për barazi gjinore – përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore.

**Në nivel komunal, janë:**

Zyrtarët komunalë për barazi gjinore: përgjegjës për promovimin e barazisë gjinore në nivel komunal.

Më shumë informata se si të kontaktohen zyrtarët relevantë komunalë në komunat tuaja përkatëse mund të gjinden në listën e burimeve në fund të këtij udhëzuesi.

## ÇFARË ËSHTË PRONA DHE ÇFARË JANË TË DREJTAT PRONËSORE?

**Prona** përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, të mirat fizike ose asetet, por gjithashtu edhe një sërë interesash të prekshëm e jo të prekshëm ekonomik.

Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në Kosovë<sup>iii</sup> rregullon llojet e pronave, që përfshin:

- Pronën e luajtshme – si automjetet, ose pronën që nuk është e lidhur fizikisht me tokën.
- Pronën e paluajtshme – si shtëpitë ose banesat, vetë tokën ose pronën tjetër që është e lidhur fizikisht me tokën.

E drejta në pronë është **e drejtë themelore e njeriut**, e njohur me nenin 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), që thotë se *secili ka të drejtë të ketë pasuri, vetë dhe në bashkësi me të tjerët dhe askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij/saj*. Gjithashtu, neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) thotë që *çdo person ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij/saj*. Parimet e DUDNJ-së dhe të KEDNJ-së, përfshi këtu të drejtën në pronë, janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë.

Megjithatë, e drejta në pronë është e drejtë e **kualifikuar** që do të thotë se i nënshtrohet kushteve apo kufizimeve të

caktuara. Korniza ligjore në Kosovë garanton të drejtën për të pasur pronë dhe thekson që shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj në përputhje me interesin publik. Për më tepër, askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga prona, por qeveria mund të shpronësojë një të tillë nëse shpronësimi është: i autorizuar me ligj; i domosdoshëm për të arritjen e një qëllimi publik ose promovimit të interesit publik; dhe kur, ata të cilët janë shpronësuar, marrin kompensim të menjëhershëm dhe të duhur.

Pronësia pra është shumë e rëndësishme për gëzimin e të drejtave pronësore: Por, çfarë është pronësia?

Pronësia i referohet një sërë të drejtash që gëzon dhe ka një mbajtës i të drejtave pronësore, e që përfshijnë:

- Të drejtën për të poseduar pronën
- Të drejtën për të transferuar pronën
- Të drejtën e të qenit të lirë nga pengimi i gëzimit të këtyre të drejtave.

Në Kosovë, të drejtat e pronësisë garantohehen përmes procesit të regjistrimit të pronës. Prandaj, dijenia se si të regjistrohet prona është thelbësore në avancimin e të drejtave pronësore të grave.

## LLOJET E REGJISTRIMIT TË PRONËS – ÇKA ËSHTË PRONËSIA E VETME?

Në Kosovë, **pronësia e vetme** i referohet gëzimit në mënyrë të vetme të së drejtës pronësore, posedimit të saj, përjashtimit të tjerëve nga çfarëdo pengimi në pronë dhe, të drejtës për të vendosur në mënyrë të pavarur për shitjen ose dhënien me qira të pronës.

**Gratë dhe burrat** mund të regjistrojnë pronën si **pronar të vetëm** kur e blejnë pronën individualisht; kur e trashëgojnë atë, dhe kur ajo transferohet vetëm në emrin e tyre<sup>iv</sup>.

Në Kosovë, **vetëm prona e paluajtshme duhet regjistruar në regjistrin kadastral**. Prona e paluajtshme regjistrohet përmes kërkesës me shkrim në zyrën kadastrale në komunën ku gjendet prona. Zyra kadastrale e komunës, më pas, e vërteton datën dhe kohën e pranimit të aplikacionit për regjistrim.

Aplikacioni për regjistrimin e një shtëpie apo banese duhet të parashtrohet nga pronari ose dikush me autorizim ligjor për regjistrimin e pronës në emër të pronarit.<sup>v</sup>

Më shumë informata se si të kontaktoni me zyrën kadastrale në komunën tuaj gjegjëse mund të gjinden në listën e burimeve në fund të këtij udhëzuesi.

## LLOJET E REGJISTRIMIT TË PRONËS – GJATË LIDHJES SË MARTESËS, GJATË MARTESËS DHE PAS MARTESËS?

Ka mënyra të ndryshme për të regjistruar pronën bashkërisht, varësisht nëse prona është në bashkëpronësi me një individ tjetër ose me bashkëshort. Kjo pjesë flet për konceptin e pronës së përbashkët ose në bashkëpronësi dhe çështje që lidhen me regjistrimin e pronës gjatë martesës, si dhe ndarjen e pronës gjatë shkurorëzimit.

**Bashkëpronësia** i referohet gëzimit të përbashkët të pronësisë ndaj një prone me një apo më shumë individë. Nëse pjesët që u takojnë pronarëve në pronë nuk caktohen paraprakisht, supozohet që të gjithë pronarët kanë pjesë të barabartë në pronë. Bashkëpronarët lejohen të shfrytëzojnë pronën në proporcion me pjesën e tyre dhe çfarëdo pasurie e mbledhur nga prona ndahet në proporcion në pjesë përkatëse.

Bashkëpronari gjithashtu ka të drejtën të disponojë me pjesën e tij/saj të pronës pa pëlqimin e pronarëve të tjerë. Megjithatë, prona me bashkëpronarë duhet të administrohet bashkërisht nga të gjithë pronarët.<sup>vi</sup>

**Bashkëpronësia** është ndryshe nga prona e përbashkët martesore, që i referohet të drejtave pronësore të barabarta të bashkëshortëve në pasurinë e fituar gjatë martesës, duke e përfshirë këtu pronën. Prandaj, çfarëdo prone apo pasurie e fituar **gjatë** martesës konsiderohet si pasuri e përbashkët e të dy palëve dhe, ligjërisht, regjistrimi i pronës bëhet në emër të të dy bashkëshortëve.

Çifti bashkëshortor ka **pjesë të barabartë** në pasurinë e mbledhur apo të fituar gjatë martesës. Megjithatë, në Kosovë, prona e përbashkët martesore shpesh nuk regjistrohet në emër të të dy bashkëshortëve. **Meqë çifti bashkëshortor ka pjesë të barabartë në pasurinë e përbashkët martesore, regjistrimi i saj duhet ta reflektojë pikërisht këtë gjë.** Pronësia mbi një pronë u ndihmon individëve të marrin kredi, ta hipotekojnë atë, të fillojnë biznes, si dhe për kolateral. Prandaj, është e rëndësishme që të dy bashkëshortët të kenë qasje të barabartë në mundësi që dalin nga fakti i të qenit pronar – që mund të jetë shumë më e vështirë nëse prona është e regjistruar në emër të vetëm njërit prej bashkëshortëve.

Jo e tërë pasuria martesore konsiderohet si **pasuri e përbashkët bashkëshortore. Pasuria e veçantë bashkëshortore** i referohet pronës që i përket ekskluzivisht njërit apo tjetrit bashkëshort. Kjo përfshinë:

- Pasurinë e **krijuar** para martesës

- Pasurinë e trashëguar ose të falur

-Pjesën e pronës së përbashkët që i takon secilit bashkëshort

-Punën artistike dhe pronën intelektuale<sup>vii</sup>

Në rastin e **shkurorëzimit** apo **zgjidhjes së martesës**, të dy bashkëshortëve u takojnë pjesë të **barabarta** të pasurisë së përbashkët martesore. Duke qenë se pasuria e fituar gjatë vazhdimit të martesës konsiderohet pasuri e përbashkët e bashkëshortëve (përveç pasurisë që është përcaktuar si **pasuri e veçantë e bashkëshortëve**), pavarësisht se a ka qenë e regjistruar në emrin e të dy bashkëshortëve apo të vetëm njërit, pasuria duhet t'u ndahet në pjesë të barabarta. Megjithatë, për t'u siguruar që gjithçka është në përputhje me Ligjin për familjen, bashkëshortët duhet të sigurohen që **pasuria e përbashkët martesore të regjistrohet gjithmonë në emrin e të dy bashkëshortëve**.

#### ÇFARË ËSHTË E DREJTA E TRASHËGIMISË?<sup>viii</sup>

**Trashëgimia** është kalimi i pasurisë nga personi i vdekur (trashëgimlënësi) tek pasardhësit (trashëgimtarët e gjallë). Trashëgimia me ligj zbatohet kur personi i vdekur nuk ka lënë testament për tërë pasurinë apo për një pjesë të saj, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.

Ekzistojnë tre rradhë të trashëgimisë:

Radha e I-rë e trashëgimisë: trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët dhe bashkëshorti – fëmijët dhe bashkëshorti trashëgojnë në pjesë të barabarta.

Radha e II-të e trashëgimisë: nëse trashëgimlënësi nuk ka pasur fëmijë, trashëgimia u kalon bashkëshortit dhe prindërve të tij – bashkëshorti dhe prindërit trashëgojnë në pjesë të barabarta.

Radha e III-të e trashëgimisë: nëse trashëgimlënësi nuk ka pasur prindër apo fëmijë, trashëgimia i kalon bashkëshortit të trashëgimlënësit – bashkëshorti trashëgon gjithë pasurinë.

**Ndonëse sipas kornizës ligjore në Kosovë burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta, ndikimi negativ i traditave patriarkale dhe praktikave zakonore shpesh bën të pamundur që gratë të gëzojnë të drejta të barabarta në trashëgimi.**

**Gratë dhe burrat duhet ta kuptojnë që radhët e trashëgimisë e përmendura më sipër vlejnë njëlloj si për burrat ashtu edhe për gratë.** Fëmijët, bashkëshortët dhe prindërit janë trashëgimtarë të domosdoshëm. Shkaqet e përjashtimit nga trashëgimi janë të kufizuar dhe janë përvijuar në Ligjin e Kosovës për trashëgimi. Procedura e shqyrtimit të rasteve të trashëgimisë mund të zhvillohet si përmes gjykatave themelore ashtu edhe noterëve në komunën përkatëse.

## E DREJTA E BANIMIT – PËRFSHIRJA E GRAVE DHE BURRAVE NË PLANIFIKIM HAPËSINOR NË NIVEL TË KOMUNËS

**Planifikimi hapësinor** i referohet procesit të planifikimit të zhvillimit apo rregullimit të një hapësire të caktuar. Çdo komunë në Kosovë ka detyrimin ligjor për të hartuar planin zhvillimor komunal, me të cilin përcaktohen planet afatgjata për zhvillimin ekonomik, social dhe fizik të komunës<sup>ix</sup>. Kështu, ai ndikon në punësim, banim, arsim, transport dhe mjedis, ndërsa përkatësia gjinore është aspekt i rëndësishëm i gjithë këtyre fushave.

Çfarë rëndësie ka gjinia?

- Jeta e përditshme që bëjnë gratë në një komunë dallon nga ajo e burrave. Nevojat, përvojat dhe prioritetet e tyre nuk janë të njëjta. Për shembull, mund të ndodhë që, në një komunë të caktuar, më pak gra të ngasin automjetin në krahasim me burrat, andaj dhe mund të kenë nevojë për sistem më të mirë dhe më të gjerë të transportit publik se sa burrat e asaj komune. Në proceset e planifikimit hapësinor duhet të dëgjohet si zëri i grave ashtu edhe i burrave, ngaqë këndvështrimet e tyre janë thelbësore për hartimin e planeve që pasqyrojnë realitetin e gjithë banorëve. Për shembull, nëse në një zonë të qytetit së cilës banorët nuk mund t'i qasen aq lehtë ndërtohet një shkollë, kjo do të ndikojë ndryshe në jetën e përditshme të grave dhe ndryshe në atë të burrave, ndonëse dallimet në fjalë jo se merren domosdoshmërisht në konsideratë dhe përfshihen në planin hapësinor përpos rasteve kur konsultohen si burrat ashtu edhe gratë.
- Në anën tjetër, dallime ka edhe midis vet grave, përkatësisht burrave, prandaj në procesin e planifikimit duhet të merren parasysh dhe të përfshihen edhe faktorë tjerë, përfshirë moshën, gjendjen socio-ekonomike dhe përkatësinë etnike. Si shembull, përvoja dhe perspektiva e një gruaje të re e të punësuar e cila nuk ka fëmijë dallon shumë nga ajo e një gruaje më në moshë me shumë fëmijë e cila mban barrën kryesore për fëmijët dhe punët e shtëpisë. Nëse në procesin e planifikimit hapësinor nuk merren parasysh si nevojat e burrave ashtu edhe të grave, do të rezultojnë plane komunale që nuk marrin në konsideratë brengat dhe prioritetet e të gjithë banorëve. Kjo mund të ndikojë më negativisht te njëri seks sesa te tjetri në kuptimin e kufizimit të mundësive për t'i gëzuar të drejtat, dhe mund të çojë në diskriminim mbi baza gjinore.

Prandaj, gjatë procesit të planifikimit hapësinor, institucionet e Kosovës jo vetëm që duhet të marrin në konsideratë çështjet gjinore, përfshirë përmes konsultimeve si me burrat ashtu edhe gratë dhe përfshirjes së nevojave dhe prioriteteve të tyre në planet komunale, por duhet gjithashtu t'i inkurajojnë të gjithë banorët pa dallim, si burrat ashtu edhe gratë, që të marrin pjesë në konsultime publike të dizajnuara enkas për t'i marrë mendimet e qytetarëve. Konsultimet publike në lidhje me planifikimin hapësinor janë të parapara me ligj, ndërsa legjislacioni i Kosovës përmban edhe dispozita tjera që kërkojnë nga institucionet që të marrin parasysh nevojat e personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, pakicave dhe rinisë në cilëndo komunë përkatëse, si edhe çështjet gjinore<sup>x</sup>. Gjithsecilit duhet t'i jepet mundësia që t'u dëgjohej zëri.

## PËRGJEGJËSITË E KOMUNAVE PËR SIGURIMIN E BANIMIT SOCIAL – PËRFSHIRJA E PERSPEKTIVËS SË BURRAVE DHE GRAVE

*Sipas nenit 25 të DUDNJ, të gjithë kanë të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm që i përgjigjet shëndetit dhe mirëqenies së tyre.*

Në mbështetje të realizimit të kësaj të drejte në Kosovë, Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit<sup>xi</sup> krijon mundësi për sigurimin e banimit të përshtatshëm për ata banorë të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave. Sigurimi i banimit social është përgjegjësi e secilës komunës. Megjithatë, e drejta e banimit është **e drejtë që realizohet në mënyrë progresive**, që do të thotë se duhet të realizohet deri në maksimumin e burimeve që i ka në dispozicion komuna. Gjithashtu, banimi social është menduar si mënyrë për t'ju dalë në ndihmë familjeve në nevojë për një kohë të caktuar, jo për t'ju siguruar zgjidhje të përhershme të banimit.

Për të bërë vlerësimin e nevojave për banim social dhe të mjeteve të nevojshme për përmbushjen e këtyre nevojave, çdo komunë në Kosovë duhet të kryejë vlerësimin e nevojave çdo tre vjet<sup>xii</sup>. Mbi bazën e këtij vlerësimi, komuna ngritë komision për përzgjedhjen e përfituesve dhe ndarjen e banesave sociale në dispozicion. Komisioni duhet t'u përmbahet disa kritereve gjatë përcaktimit të përfituesve të banesave sociale.

**Komuna duhet të bëjë njoftim publik për thirrjen për aplikime për banim social, nëpër medie dhe në tabelën e shpalljeve, në gjuhën shqipe dhe në atë serbe, si dhe në çdo gjuhë tjetër në përdorim zyrtar në komunën përkatëse.**

Kategoritë e familjeve që mund të aplikojnë për banesë sociale përfshijnë familjet që:

- nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi të tyre,
- kanë mbetur pa banesë apo shtëpi si rrjedhojë e dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë,
- posedojnë sipërfaqe banimi nën normat minimale të hapësirës për jetesë.

Gjithashtu, gjatë ndarjes së banesave sociale u jepet përparësi kategorive të mëposhtme të familjeve:

- familjet që jetojnë në ndërtesa që përbëjnë rrezik,
- familjet me të ardhura të pakta,
- familjet që kanë në përkujdesje persona me aftësi të kufizuara,
- familjet me shumë fëmijë apo të moshuar.

Kur bëhet fjalë për qasjen në banim social, nevojat dhe brengat e grave dallojnë nga to të burrave. Për shembull, duke qenë se ka më shumë të ngjarë që gratë ta kenë rolin kryesor për përkujdesjen ndaj fëmijëve, atëherë kushtet e banimit dhe afërsia e banesave sociale me shkollat mund të mos kenë ndikim dhe aq të madh tek burrat sa do të kishin tek gratë. Ose, nëse është gruaja ajo që mban barrën kryesore për punët e shtëpisë edhe fëmijët, atëherë edhe furnizimi me ujë të pijshëm dhe rrymë elektrike apo afërsia e dyqaneve të ushqimeve dhe shërbimeve tjera do të ndikojnë ndryshe tek ajo. Duke qenë se ka më pak të ngjarë që gruaja të ngasë një automjet, atëherë edhe vendndodhja e banesës sociale mund të ketë ndikim të madh në mundësitë e saj për të kryer obligime të atilla si ato që u përmendën më lart. Andaj, aspektet sikurse ndriçimi i rrugëve dhe qasja në shërbime të transportit publik mund të perceptohen ndryshe nga gratë dhe ndryshe nga burrat si rrjedhojë e perceptimeve të ndryshme mbi sigurinë. Fakti që gratë dhe burrat mund të kenë prioritete dhe brenga të ndryshme duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të nevojave për banim social në nivel të komunës, si edhe gjatë procesit të ndarjes së banesave.

Në anën tjetër, midis grave dhe burrave mund të ketë dallime edhe sa i përket mënyrës së arritjes deri te informata në komunën përkatëse. Për shembull, nëse gjasat që gratë mund të informohen rreth zhvillimeve në komunë përmes tabelës së shpalljeve apo vendeve tjera ku komuna i vendosë shpalljet janë më të ulëta, atëherë masat më proaktive, sikurse vizitat informuese nëpër fshatra ose angazhimi i zyrtarëve komunalë për barazi gjinore dhe grupeve komunale të grave, mund të ketë ndikim pozitiv në nxitjen e pjesëmarrjes së grave.

## VENDBANIMET JOFORMALE DHE NDIKIMI I TYRE TE GRATË DHE BURRAT

**Vendbanimet joformale** janë një problematikë tjetër e banimit që duhet të shqyrtohet karshi ndikimit që e ka te gratë dhe burrat. Në Kosovë, vendbanimet joformale u referohen vendbanimeve që kanë një a më shumë prej karakteristikave të vijim:

- zotërimi joformal i pronësisë;
- qasja joadekuate ose privimi nga shërbimet themelore sikurse furnizimi me ujë të pijshëm dhe rrymë elektrike ose sistemet të mbledhjes së ujërave të zeza;
- pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje – përfshirja në vendimmarrje (për shembull, gjatë hartimit të dokumenteve komunale të planifikimit hapësinor);
- rrezik i madh i dëmtimit të integritetit struktural të objektit.<sup>xiii</sup>

Në Kosovë, institucionet qendrore dhe lokale janë të detyruara me ligj që të rregullojnë vendbanimet joformale që i kanë identifikuar në dokumentet komunale të planifikimit hapësinor. Janë tre mënyra për ta bërë këtë:

- Përmirësimi i kushteve të jetesës në vendbanimin joformal – përfshirë infrastrukturën dhe shërbimet;
- Shembja dhe rindërtimi i vendbanimit me infrastrukturë dhe shërbime adekuate. Kjo nënkupton që banorët do të duhet të zhvendosen tjetërkund përkohësisht.
- Shembja dhe zhvendosja e tërë vendbanimit dhe banorëve në një vend tjetër. Ky veprim propozohet në rastet kur vendbanimi ndodhet shumë afër ndonjë zone potencialisht të rrezikshme si, për shembull, kur vendbanimit ndodhet shumë afër deponisë komunale të mbeturinave apo ndonjë toke të kontaminuar.<sup>xiv</sup>

Komponent i rëndësishëm i rregullimit të vendbanimeve joformale është prioritizimi i shërbimeve që duhet të ofrohen për ta bërë vendbanimin të përshtatshëm për jetesë. Megjithatë, burrat dhe gratë mund të kenë mendime të ndryshme për atë se cilat shërbime janë më me prioritet e cilat jo, dhe çfarë nevojash e brengash kanë në të vërtetë banorët e vendbanimit joformal. Ashtu si te banimi social, komunat kanë detyrimin ligjor që të mbajnë konsultime publike me banorët gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor. Llojet dhe mënyra e ofritit të shërbimeve në vendbanimet joformale, si dhe metodat e përdorura nga komuna për ta adresuar çështjen e legalizimit të vendbanimeve joformale, mund të kenë



tjetër ndikim të burrat e tjetër të gratë - kjo duhet të merret parasysh gjatë hartimit të planeve komunale dhe procesit të rregullimit të vendbanimeve joformale (shih më sipër shembujt lidhur me banimin social).

## CILËT JANË HISEDARËT NË KOMUNË?

### **Njësitë komunale për të drejta të njeriut (NJKDNJ) dhe zyrtarët komunalë për barazi gjinore (ZKBGJ)**

NJKDNJ-të dhe ZKBGJ-të janë mekanizma përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal dhe sipas ligjeve, politikave dhe standardeve ndërkombëtare. ZKBGJ-të kanë detyrën kryesore për të udhëhequr me programe komunale të lidhura me barazinë gjinore në mënyrë që të sigurojnë zbatimin e Ligjit për barazi gjinore dhe standardeve të tjera gjegjëse të të drejtave të njeriut.

### **Zyrtarët komunalë të kadastrit (ZKK)**

ZKK-të merren me regjistrimin e tokës në pronësi private dhe tokës në pronësi të komunës. Gjithashtu, ata zhvillojnë procedura administrative për kthimin e tokës te pronari, si dhe identifikojnë dhe vendosin masa të përkohshme në lidhje me tokën deri në nxjerrjen e vendimit gjyqësor. ZKK-të janë përgjegjës edhe për regjistrimin e hipotekave dhe mbajtjen, korrigjimin dhe harmonizimin e të dhënave kadastrale për vendbanimet, fshatrat, rrugët dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave.

### **Organizatrat joqeveritare (OJQ)**

OJQ-të mund të luajnë rol të rëndësishëm në avokim dhe lobim për të drejtat e grave. OJQ-të që janë përfshirë në listën e burimeve në këtë dokument punojnë në mënyrë specifike për avancimin e barazisë gjinore dhe qasjes së barabartë në të drejtën e banimit dhe pronës. Lista nuk është shteruese, por bazohet në hulumtimet e OSBE-së në terren.

### **Zyrtat rajonale për ndihme juridike falas**

Zyrtat rajonale për ndihmë juridike falas i ofrojnë ndihmë juridike falas çdo qytetari që i plotëson kriteret. Ata mund t'ua lehtësojnë grave qasjen në të drejtën në pronë, duke u dhënë këshilla dhe informata gjithë grave të cilat nuk kanë qenë në dijeni për të drejtat që i gëzojnë në lidhje me pronën, si dhe duke i përfaqësuar gratë para gjykatës apo organeve administrative dhe duke u ndihmuar me hartimin e shkresave ligjore dhe sqarimin e procedurave.

### **Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)**

IAP është institucion i pavarur me mandat për të adresuar pohimet për shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve publike në Kosovë. IAP zhvillon hetime, nxjerr raporte, ofron shërbime juridike, si dhe avokim publik. Të gjitha shërbimet IAP i ofron pa pagesë dhe pranon ankesa nga çdokush në Kosovë.

### **Noteria**

Shërbimi i noterisë është shërbim juridik dhe publik që ka si qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizik dhe juridik. Noteri është jurist profesional, zyrtar publik, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë. Funkcionet e noterit janë: përpilimi dhe vërtetimi i kontratave, noterizimi i deklaratave, vërtetimi i nënshkrimeve, trajtimi i aspekteve të caktuara të rasteve të trashëgimisë në procedurë jokontestimore dhe detyra tjera siç janë përcaktuar me Ligjin për noterinë<sup>xv</sup>, prej të cilit rrjedh mandati dhe funksionet e noterëve.

## LISTA E BURIMEVE

### LEGJENDA E SHKURTESAVE

CRP/K	Programi për të Drejtat Civile në Kosovë
ZRNJF	Zyrë rajonale për ndihmë juridike falas
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
ZKBGJ	Zyrtar komunal për barazi gjinore
NJKDNJ	Njësi komunale për të drejtat e njeriut
ZKK	Zyrë komunale kadastrale
GPK	Grup punues komunal
OJQ	Organizatë joqeveritare

### SHËNIM:

- Për të rënë në kontakt me zyrën përkatëse në kuadër të një komune, duhet që të telefononi në numrin kryesor për informata të paraqitur për secilën komunë në vijim.
- Për të rënë në kontakt me ndonjë drejtori tjetër veç atyre të cekura në vijim, ose kur mungojnë informata e kontaktit për ZKBGJ, NJKDNJ, ose ZKK, telefononi në numrin për informata të përgjithshme të komunës të dhënë për secilën komunë veç e veç.
- Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të kontaktohet vetëm pasi që të jenë shterur përpjekjet për kontakt me gjithë organet përgjegjëse.

KOMUNA DEČAN/DEČANE .....	20
KOMUNA DRAGASH/DRAGAŠ .....	21
KOMUNA FERIZAJ/UROŠEVAC .....	22
KOMUNA FUSHË KOSOVË/KOSOVO POLJE .....	23
KOMUNA GJAKOVË/ĐAKOVICA .....	24
KOMUNA GJILAN/GNJILANE .....	25
KOMUNA GLOGOC/GLOGOVAC .....	26
KOMUNA GRAČANICA/GRAČANICË .....	27
GJKATA THEMELORE NË PRISHTINË/PRIŠTINA .....	27
DEGA NË GRAČANICË/GRAČANICA .....	27
KOMUNA HAN I ELEZIT/ELEZ HAN .....	28
KOMUNA ISTOG/ISTOK .....	29
KOMUNA JUNIK .....	30
KOMUNA KAÇANIK/KAČANIK .....	31
KOMUNA KAMENICË/KAMENICA .....	31
KOMUNA KLINË/KLINA .....	32
KOMUNA KLOKOT/KLLOKOT .....	33
KOMUNA LEPOSAVIÇ/LEPOSAVIQ .....	33
KOMUNA LIPJAN/LIPLJAN .....	34
KOMUNA MALISHEVË/MALIŠEVO .....	35
KOMUNA MAMUŠA/MAMUSHË/MAMUŠA .....	35
KOMUNA E MITROVICËS JUGORE /JUZNA MITROVICA .....	36
KOMUNA E MITROVICËS VERIORE /SEVERNA MITROVICA .....	37
KOMUNA NOVO BRDO/NOVOBËRDË .....	39
KOMUNA OBILIQ/OBILIÇ .....	39
KOMUNA PARTEŠ/PARTESH .....	40
KOMUNA PEJË/PEÇ .....	40
KOMUNA PODUJEVË/PODUJEVO .....	42
KOMUNA PRISHTINË/PRIŠTINA .....	43
KOMUNA PRIZREN .....	45
KOMUNA RANILUG/RANILLUG .....	47
KOMUNA RAHOVEC/ORAHOVAC .....	48
KOMUNA ŠTRPCE/SHTËRPÇË .....	49

KOMUNA SHTIME/ŠTIMLJE .....	50
KOMUNA SKËNDERAJ/SRBICA.....	50
KOMUNA SUHAREKË/SUVA REKA .....	52
KOMUNA VITI/VITINA.....	52
KOMUNA E VUSHTRISË/VUÇITRN.....	53
KOMUNA E ZUBIN POTOKUT.....	54
KOMUNA ZVEÇAN/ZVEÇAN.....	54

## KOMUNA DEÇAN/DEÇANE

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAILI	TELEFONI
Komuna Deçan/Deçane	Sheshi Mentor Tolaj	Nuk është në dispozicion	+381 (0)390 361 100
ZKBGJ/NJKDNJ	Shtëpia e Kulturës, kati i dytë	<a href="mailto:zoelse@yahoo.com">zoelse@yahoo.com</a> , <a href="mailto:zoelse@hotmail.com">zoelse@hotmail.com</a>	0390361100
Stacioni i Policisë së Kosovës	Nuk gjendet në dispozicion	<a href="mailto:info@kosovopolice.com">info@kosovopolice.com</a>	92 (fikse) 192 (mobile)
Institucioni i Avokatit të Popullit	Mbulohet nga Zyra Rajonale në Pejë/Peć rr. Mbretëresha Teutë, No. 59	Nuk është në dispozicion	+381 (0)39 432 931
Gjykata Themelore	Gjykata Themelore Pejë/Peć Dega në Deçan/Deçane Sheshi Mentor Tolaj	Nuk është në dispozicion	+381 (0)39 433 725
Prokuroria Themelore	Mbulohet nga Prokuroria Themelore Pejë/Peć	Nuk është në dispozicion	+381 (0)39 432 467

OJQ-të	ADRESA	EMAILI	TELEFONI	SYNIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Shoqata e Grave "Jeta" /"Život"	Shtëpia e Kulturës, Jusuf Gervalla Rr. Skenderbeg	<a href="mailto:ojqjeta@hotmail.com">ojqjeta@hotmail.com</a> <a href="mailto:ojqjeta@yahoo.com">ojqjeta@yahoo.com</a>	039061375	Të rrisë vetëdijen për të drejtat e grave dhe të përforcojë rolin e tyre në shoqëri	Gratë, të moshuarit, si dhe viktimat potenciale të dhunës në familje	- Vetëdijesimi për të drejtat e grave - Shëndeti dhe edukimi - Kurse ondulomi, qepjeje dhe qëndisjeje
Nderi/Čast	Qendra për Punë Sociale Rr. UÇK	Nuk është në dispozicion	049452691	Të rrisë vetëdijen për të drejtat e grave dhe të përforcojë rolin e tyre në shoqëri	Gratë	- Vetëdijesimi për të drejtat e grave

## KOMUNA DRAGASH/DRAGAŠ

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAILI	TELEFONI
Komuna Dragash/Dragaš	Rr. Sheshi i Dëshmorëve	Nuk është në dispozicion	+381 (0)29 281 005
ZKBGJ dhe NJKDNJ	Ndërtesa e Komunës, Rr. Sheshi i Dëshmorëve	Nuk është në dispozicion	029281543
Stacioni i Policisë së Kosovës	Nuk është në dispozicion	info@kosovopolice.com	92 (fikse) 192 (mobile)
Institucioni i Avokatit të Popullit	Mbulohet nga Zyra Rajonale Prizren		
Gjykata Themelore	Gjykata Themelore në Prizren Dega Dragash/Dragaš Sheshi i Dëshmorëve, pn	Afërdita Kicaj <a href="mailto:aferdita.kicaj@rks-gov.net">aferdita.kicaj@rks-gov.net</a> (Zyrtare e Shtypit dhe Informimit Publik -ZIP)	029 222 125 045 418 632
Prokuroria Themelore	Nën Prokurorinë Themelore në Prizren Uilliam Uoker, pn	U.D. Kryeprokuror Metush Biraj <a href="mailto:metush.biraj@rks-psh.net">metush.biraj@rks-psh.net</a> Nuk ka ZIP	029223163

OJQ-të	ADRESA	EMAILI	TELEFONI	SYNIMET	PWRFITUESIT	AKTIVITETET
Women's initiative/ Iniciativa e grave/ Inicijativa zëna	Sheshi i dëshmorëve, p.n.	Nuk është në dispozicion	Nuk është në dispozicion	Të përkrahë gratë në komunën e Dragashit/Dragaš	Gratë	- Promovimi i barazisë gjinore, fuqizimi i grave, edukimi shëndetësor për gratë - Vetëdijesimi mbi dhunën në familje
Mekanizmi koordinues kundër Dhunës në Familje	Ndërtesa e komunës Rr. Sheshi i Dëshmorëve,	Nuk është në dispozicion	Nuk është në dispozicion	Të bëjë reagimin e menjëhershëm dhe gjithëpërfshirës ndaj dhunës në familje, koordinimi efektiv i	Viktima të dhunës familjare	- Mbledhjet e rregullta të grupit; - Ndhima në implementim të strategjisë kundër dhunës

				reagimit institucional në adresim të rasteve të dhunës, si dhe kontributi në krijimin e politikave proaktive kundër dhunës në familje në Komunën e Dragashit/ Dragaš.		në familje
--	--	--	--	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	------------

## KOMUNA FERIZAJ/UROŠEVAC

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAILI	TELEFONI
Komuna Ferizaj/Uroševac	Rr. Dëshmorët e Kombit	Nuk është në dispozicion	+381 (0) 290 320 150
ZKBGJ/NJKDNJ	Rr. Dëshmoret e Kombit	vjollcank.@hotmail.com	+381 (0) 290320591
Stacioni i Policisë së Kosovës	rr. Reçaku n.n	info@kosovopoliice.com	92 (fikse) 192 (mobile)
Institucioni i Avokatit të Popullit	Mbulohet nga Zyra Rajonale në Gjilan/Gnjilane Ndërtesa e komunës II Rr. Adem Jashari	Nuk është në dispozicion	+381 (0)280 320 843
Gjykata Themelore	Rr. Dëshmorët e Kombit n.n	<a href="mailto:Albenora.bekteshi@rks-gov.net">Albenora.bekteshi@rks-gov.net</a> <a href="mailto:albenorabekteshi@hotmail.com">albenorabekteshi@hotmail.com</a>	+381 (0) 290/321-009
Prokuroria Themelore	Rr. Dëshmorët e Kombit n.n		+381 (0) 290/ 326-017 +377 (0) 44 378 584

GRUPI PUNUES KOMUNAL	ADRESA	EMAILI	TELEFONI	SYNIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Komisioni për Barazi Gjinore	Ndërtesa e Komunës, Rr. Dëshmoret e Kombit	Nuk është në dispozicion	0290320591	Të ofrojë forum diskutimi për faktorët relevantë komunalë në lidhje me dhunën me bazë gjinore	Gratë, vajzat dhe fëmijët	- Aktivitetet e vetëdijesimit - Ndarja e informatave



OJQ-të	ADRESA	EMAILI	TELEFONI	SYNIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
AJO	Shkolla Jeronim De Rada (në oborr të shkollës) Nuk ka emër apo numër të rrugës	<a href="mailto:ugafrودita@hotmail.com">ugafrودita@hotmail.com</a>	Maria Kurti +377(0) 44/286-319	Promovimi i mirëqenies së grave dhe fëmijëve Luftimi i dhunës me bazë në gjini, veçanërisht në lidhje me viktimat e trafikimit	Gratë, fëmijët dhe rinia	- Emancipimi i grave, shëndeti dhe kujdesi social - Edukimi - Vetëdijesimi - Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe arsimore

## KOMUNA FUSHË KOSOVË/KOSOVO POLJE

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAILI	TELEFONI
Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje	Rr. Nëna Terezë	Nuk është në dispozicion	+381 (0)38 536 006
ZKBGJ dhe NJKDNJ	Rr. Nëna Terezë	<a href="mailto:linditadervisholli@hotmail.com">linditadervisholli@hotmail.com</a>	038537537
Stacioni i Policisë së Kosovës	Nuk është në dispozicion	<a href="mailto:info@kosovopolice.com">info@kosovopolice.com</a>	92 (fikse) 192 (mobile)
Institucioni i Avokatit të Popullit - Mbulohet nga the Prishtinë/Priština Office	Rr. Enver Maloku, Nr. 28	Nuk është në dispozicion	+381 (0)38 501 401 +381 (0)38 545 303
Gjykata Themelore	Mbulohet nga Prishtinë/Priština Gjykata Themelore	Nuk është në dispozicion	+381 (0) 38 248 805
Prokuroria Themelore	Mbulohet nga Prishtinë/Priština Prokuroria Themelore	Kryeprokurori Themelor Imer Beka <a href="mailto:Imer.Beka@rks-gov.net">Imer.Beka@rks-gov.net</a>	+381 (0) 200 18 848

## KOMUNA GJAKOVË/ĐAKOVICA

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAILI	TELEFONI
Komuna Gjakovë/Đakovica	Rr. Nëna Terezë, pn	Nuk është në dispozicion	+381 (0)390 321 100
ZKBGJ/NJKDNJ	Ndërtesa e Komunës Rr. Nëna Terezë, nr.469	lumnijeshllaku@hotmail.com	03904321100; 044424541
ZKK			+381 (0)390 321 504
Institucioni i Avokatit të Popullit	Mbulohet nga Pejë/Peç Field Office Rr. Mbretëresha Teutë, No. 59	Nuk është në dispozicion	+381 (0)39 432 931
Gjykata Themelore	Rr. Bardhyl Qaushi, No. 158	Nuk është në dispozicion	+381 (0)390 324 130
Prokuroria Themelore	Rr. Nëna Tereze, nn	Nuk është në dispozicion	+381 (0)390 322 419

OJQ-të	ADRESA	EMAILI	TELEFONI	SYNIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Bethany Christian Service	Qendra Komunitare Fshati Brekoc/Brekovac, Komuna Gjakovë/Đakovica	<a href="mailto:Berat_thaqi22@hotmail.com">Berat thaqi22@hotmail.com</a> ; <a href="mailto:Berat71@yahoo.com">Berat71@yahoo.com</a>	044134471	Përkrahja e të gjitha komuniteteve, sidomos në fushat sociale dhe arsimore	Rinia nga të gjitha komunitetet, sidomos nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	- Arsimi dhe kujdesi social
Prosperiteti	Rr. Ali Pashë Tepelena	shoqata-prosperiteti@hotmail.com	044714458	Përkrahja e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës	komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës	- Edukim dhe kulturë - Barazi gjinore - Asistencë humanitare - Riintegrimi i personave të riatdhesuar
Medica Kosova	Rr. Luigj Gurakuqi, No. 39	medicam_kosova@yahoo.com	0390321139 044247187	Sigurimi i përkrahjes psikologjike, ligjore dhe	Gratë dhe vajzat nga të gjitha komunitetet	- Këshillim - Edukim

				mjekësore për gratë dhe vajzat		
Asociacioni për edukim dhe mbështetje për familje	Rr. Nëna Terezë, No. 181	<a href="mailto:shepfgiakova@yahoo.com">shepfgiakova@yahoo.com</a>	044152051	Këshillim ligjor dhe psiko-social	Gratë nga të gjitha komunitetet	- Këshillim - Përkrahje ligjore
OJQ Femra Aktive	Sulejman Vokshi nr1	<a href="mailto:f_aktive@yahoo.com">f_aktive@yahoo.com</a>	044188642	Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut P	Gratë nga të gjitha komunitetet	Vetëdijesim, edukim dhe avokim për trashëgiminë dhe çështje familjare

## KOMUNA GJILAN/GNJILANE

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAILI	TELEFONI
Komuna Gjilan/Gnjilane	Rr. Adem Jashari	Nuk është në dispozicion	+381 (0)280 323 323 311 +381 (0)280 226 428
ZKBGJ/NJKDNJ	Objekti i Kuvendit Komunal, Rr. Bulevardi I Pavarësisë	<a href="mailto:dritaulqini@gmail.com">dritaulqini@gmail.com</a>	+ 381 (0)280326428, ext 112
MCO			+381 (0) 280320142
CRP/K	Nuk është në dispozicion	<a href="mailto:crp.gl@crpkosovo.org">crp.gl@crpkosovo.org</a>	+381 (0)280 325 500
Legal Aid - DBLA	Rr. Mulla Idrizi, No. 41	Nuk është në dispozicion	+381 (0)280 321 134
Institucioni i Avokatit të Popullit	Gjilan/Gnjilane Field Office Ndërtesa e Komunës II Rr. Adem Jashari	Nuk është në dispozicion	+381 (0)280 320 843
Gjykata Themelore	Gjilan/Gnjilane Gjykata Themelore Rr. Bujanoc, near to T.C. Agmia	<a href="mailto:sabit.shkodra@rks-gov.net">sabit.shkodra@rks-gov.net</a> (Gjilan/Gnjilane Gjykata Themelore Spokesperson)	Tel. fix +381 280 320 043 Tel. fax +381 280 320 120
Prokuroria Themelore	Gjilan/Gnjilane Prokuroria Themelore Rr. "Reshat Ymeri" nn. 60 000, Gjilan/Gnjilane	Nuk është në dispozicion	+381/280/325-521

GRUPI PUNUES KOMUNAL	ADRESA	EMAILI	TELEFONI	SYNIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Komisioni për Barazi Gjinore	Ndërtesa e Kryetarit të Komunës Rr. 28 Nëntori	Nuk është në dispozicion	+ 381 (0) 280326428, ext 112 + 377 (0)44873203	Koordinimi i veprimeve kundër dhunës në familje në nivel komunal (me fokus tek gratë)	Gratë e prekura nga dhuna në familje	- Aktivitetet e vetëdijesimit - Organizimi i debateve - Shpërndarja e materialeve informative për të drejtat e grave

OJQ-të	ADRESA	EMAILI	TELEFONI	SYNIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Action for Non Violence and Peace Building <sup>1</sup>	Rr. Ferizaj	Anp_kos@yahoo.com	+ 381 (0) 280329926 +377 (0) 44230849	Të krijojë shoqërinë ndëretnike në Kosovë dhe të promovojë kulturën pa dhunë	Fëmijët, rinia, gratë, të moshuarit dhe aktivistët e OSHC-ve	- Fushata e avokimit për parandalim të konflikteve - Ngritja e vetëdijes kundrejt diskriminimit

## KOMUNA GLOGOC/GLOGOVAC

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAILI	TELEFONI
ZKBGJ	Rr. Skenderbeu	zahriepodrimqaku@hotmail.com	(ZKBGJ)038584353 044193439
Komuna Glogoc/Glogovac	Rr. Fehmi e Xhevë Lladrovci	Nuk është në dispozicion	+381 (0)38 584 074
MCO			+381 (0)38-584-032
Stacioni i Policisë së Kosovës	Rr. Feronikli	<a href="mailto:info@kosovopoliice.com">info@kosovopoliice.com</a>	92 (fiksë) 192 (mobile)
Institucioni i Avokatit të Popullit	Mbulohet nga Zyra rajonale e Prishtinës/Priština dhe Mitrovicës/Mitrovica		
Gjykata Themelore	Gjykata Themelore në Prishtinë/Priština Dega në Glogoc/Glogovac	Kryetari i Degës së Gjykatës Avdi Haxhaj <a href="mailto:Avdi.Haxhaj@rks-gov.net">Avdi.Haxhaj@rks-gov.net</a>	+381 38 584-020

<sup>1</sup> Aksioni kundër dhunës dhe ndërtimi i paqes/ Akcija za nenasilje i izgradnju mira

Prokuroria Themelore	Mbulohet nga Prokuroria në Prishtinë/Priština	Kryeprokurori Themelor Imer Beka <a href="mailto:Imer.Beka@rks-gov.net">Imer.Beka@rks-gov.net</a>	+381 (0) 200 18 848
----------------------	-----------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------

OJQ-të	ADRESA	EMAILI	TELEFONI	SYNIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve <sup>2</sup>	Rr. Skenderbeu	<a href="mailto:cpvcdrenas@yahoo.com">cpvcdrenas@yahoo.com</a>	Nuk është në dispozicion	- Ofrimi i përkrahjes për viktimat e dhunës në familje	Gratë dhe fëmijët	- Përkrahje psikologjike - Aftësim profesional

## KOMUNA GRAČANICA/GRAČANICË

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAILI	TELEFONI
Komuna Gračanica/Gračanicë	Rr. Hotel Dukat, rruga kryesore	Nuk është në dispozicion	Nuk është në dispozicion
ZKBGJ dhe NJKDNJ	Ndërtesa e Komunës, (rruga kryesore drejt Gjilanit/Gnjilane)	<a href="mailto:Marija.stojanovic038@gmail.com">Marija.stojanovic038@gmail.com</a>	049773289
Institucioni i Avokatit të Popullit	Rruga kryesore, përballë Manastirit	Nuk është në dispozicion	+381 (0)38 65 118
Gjykata Themelore	Gjykata Themelore në Prishtinë/Priština Dega në Gračanicë/Gračanica	Kryetari i Degës së Gjykatës Ferki Xhaferi <a href="mailto:Ferki.xhaferi@rks-gov.net">Ferki.xhaferi@rks-gov.net</a>	+ 381 (38) 200 18 534
Prokuroria Themelore	Mbulohet nga Prokuroria në Prishtinë/Priština	Kryeprokurori Imer Beka <a href="mailto:Imer.Beka@rks-gov.net">Imer.Beka@rks-gov.net</a>	+381 (0) 200 18 848

<sup>2</sup> Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve.

OJQ-të	ADRESA	EMAILI	TELEFONI	SYNIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
Dora-Dorës <sup>3</sup>	Ugljare/Uglar (fqinj me restorantin “Jastreb”)	<a href="mailto:udruzenjezenarukaruci@gmail.com">udruzenjezenarukaruci@gmail.com</a>	044 839 986	- Të promovojë barazinë gjinore - Të zhvillojë kapacitetet e grave	Gratë dhe vajzat, sidomos nga zonat rurale	- Vetëdijesimi për barazi gjinore - Kurse për gra (si trajnimet për bujqësi) - përkrahja psikologjike - Ndihma juridike dhe këshillim

## KOMUNA HAN I ELEZIT/ELEZ HAN

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAILI	TELEFONI
Komuna Han i Elezit/Elez Han	Rr. Nuri Bushi	Nuk është në dispozicion	+381 (0)290 385 112
ZKBGJ/NJKDNJ	Rr. Nuri Bushi	<a href="mailto:ajete_berisha@live.com">ajete_berisha@live.com</a>	+381 (0)290385100 (ZKBGJ: lok 208), (NJKDNJ: lok 213)
Stacioni i Policisë së Kosovës	Rr. Imri Curri n.n	<a href="mailto:info@kosovopolic.com">info@kosovopolic.com</a>	92 (fikse) 192 (mobile)
Institucioni i Avokatit të Popullit	Mbulohet nga Zyra Rajonale në Gjilan/Gnjilane Ndërtesa e Komunës II Rr. Adem Jashari	Nuk është në dispozicion	+381 (0)280 320 843
Gjykata Themelore	Mbulohet nga Gjykata Themelore në Ferizaj/Uroševac dhe Gjykata Themelore në Kaçanik/Kaçanik		
Prokuroria Themelore	Mbulohet nga Prokuroria Themelore në Ferizaj/Uroševac		

<sup>3</sup> Dora Dorës/Ruka Ruci.

## KOMUNA ISTOG/ISTOK

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAILI	TELEFONI
Komuna Istog/Istok	Rr. Fadil Ferati	Nuk është në dispozicion	+381 (0)39 451 202
ZKBGJ/NJKDNJ	Rr. Fadil Ferati	<a href="mailto:sanie_55@hotmail.com">sanie_55@hotmail.com</a>	039451202 lok 106; 044184644
MCO			+381(0)39 451 233
Stacioni i Policisë së Kosovës	Nuk është në dispozicion	<a href="mailto:info@kosovopolic.com">info@kosovopolic.com</a>	92 (fikse) 192 (mobile)
Institucioni i Avokatit të Popullit	Mbulohet nga Zyra Rajonale në Pejë/Pec Rr. Mbretëresha Teutë, Nr. 59	Nuk është në dispozicion	+381 (0)39 432 931
Gjykata Themelore	Gjykata Themelore në Pejë/Pec Dega në Istog/Istok Rr. Fadil Ferati	Nuk është në dispozicion	+381 (0)39 451 020
Prokuroria Themelore	Mbulohet nga Prokuroria Themelore në Pejë/Pec		+381 (0)39 432 467

OJQ-të	ADRESA	EMAILI	TELEFONI	SYNIMET	PËRFITUESIT	AKTIVITETET
ABA-k Education, Co-existence, Crafts/Kosovo <sup>4</sup>	Rr. Lidhja e Prizrenit	<a href="mailto:shogata-aba@hotmail.com">shogata-aba@hotmail.com</a>	039450179	Përkrahja dhe ndihma për grupe të cënueshme dhe të marginalizuara	Gjitha grupet e cënueshme dhe të marginalizuara, me fokus të veçantë tek gratë dhe fëmijët	- Këshillim - referimi i rasteve tek institucionet përkatëse - Aftësim profesional
ion 02 <sup>5</sup>	Pallati i Kulturës Rr. Skënderbeu	Vision02ojq@hotmail.com vision02ojq@yahoo.com	044522793	Nxitja e barazisë gjinore dhe dialogut ndëretnik Kontribuimi në procesin e kthimit dhe riintegritimit, si dhe zhvillimit ekonomik lokal	Rinia dhe gratë e të gjitha komuniteteve	-Aktivitete vetëdijesimi dhe zhvillimi kapacitetesh - Përkrahja psikologjike - Këshillimi - Ndihe për përfitues në krijim të bizneseve të vogla

<sup>4</sup> ABA-k Arsimit, Bashkëjetesë, Artizanate/Kosovë / ABA-k Obrazovanje, Koegzistencia, Zanatstvo/Kosovo.

<sup>5</sup> Vizioni 02/ Vizioni 02.

## KOMUNA JUNIK

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAILI	TELEFONI
